

FIGURA TË SHQUARA SHQIPTARE NË SHTYPIN FRANCEZ

BOTIMET TOENA

AURENC BEBJA

ISMAIL QEMALI

NË SHTYPIN FRANCEZ TË KOHËS

1897 - 1919

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-34-5

ISBN 978-9928-327-36-9 (Kolana)

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

PËRMBAJTJA

Ismail Qemali në shtypin francez të kohës	9
Propozimi që i bëri Ismail Qemali sulltanit për të shpëtuar Perandorinë Osmane.....	11
Arrestimi i Ismail Bej Qemalit.....	13
Turqi.....	14
Arratisja e Qemal Beut.....	16
Qemal Beu. Urimet e Mahmud Pashës - Reformat në Turqi.....	18
Ismail Qemal Beu	20
Dënim dhe urdhërarresti	22
Dr. Loris-Melikoff sapo ka marrë nga Ismail Qemal Beu, letrën e mëposhtme	25
Turqi - një program reformash.....	27
Intervistë e Ismail Qemal Beut: Kushtetuta do të zgjasë.....	29
Deklaratat e Ismail Qemalit, kreu i Bashkimit Liberal	32
Shqiptarët	35
Ismail Qemal Beu dhe çështja e Shqipërisë.....	37
Çështja e Ballkanit, çfarë do të ndodhë me regjimin xhonturk? Deklarata të rëndësishme të Ismail Qemal Beut	39
Revolta shqiptare një intervistë me Ismail Qemal Beun.....	46
Letër nga Turqia. Intervistë me Ismail Qemal Beun, Kryetarin e Partisë Liberale të Moderuar.....	48

Revolta shqiptare. Frika e një kryengritjeje në Shqipërinë jugore	53
Çështja shqiptare	55
Vizita e Ismail Qemalit në Vjenë shqetëson Turqinë	56
Intervistë e Ismail Bej Qemalit	57
Deklaratat e shefit shqiptar, Ismail Qemal Beut	59
Intervista e shefit shqiptar Ismail Qemalit	62
Ismail Qemali për “Neue Freie Presse”: Serbia nuk ka asnjë të drejtë të përparojë drejt Adriatikut dhe të copëtojë Shqipërinë..64	
Shqiptarët dhe pavarësia	65
Pavarësia e Shqipërisë.....	66
Letër nga Vjena. Ismail Qemali dhe çështja shqiptare.....	67
Në Durrës. Ardha e Ismail Qemal Beut	73
Çështja shqiptare	76
Deklaratë e Qemal Beut	78
Deklaratë e Ismail Beut.....	79
Një telegram nga kreu i qeverisë së përkohshme shqiptare për fuqitë e mëdha.....	81
Anglia dhe shqiptarët	83
Opinion i Ismail Qemalit për çështjen e Shqipërisë	86
Shpresat dhe projektet e Ismail Bej Qemalit.....	88
Një komitet shqiptar.....	91
Drejt Shqipërisë. Shënimet e dukës Montpensier	93
Çështja shqiptare një kërkesë nga Ismail Qemali	100
Çështja shqiptare	102
Ismail Qemali është në Paris. Kreu i qeverisë së përkohshme shqiptare ankohet për qëndrimin e fuqive	103
Deklarata të Ismail Qemal Beut.....	106
Ismail Bej Qemali në Quai d’Orsay.....	109

Shqipëria nuk e do mbikëqyrjen Turke.....	111
Roosevelt-i, mbreti i Shqipërisë.....	114
Shtetet e Bashkuara: “Z. Roosevelt, mbret i Shqipërisë!”	115
Sulmi shqiptar ndaj serbëve. Dëshmia e ofensivës.....	116
Shtypi i huaj. Pavarësia shqiptare	118
Në Shqipëri. Dorëheqja e Ismail Qemalit.....	120
Ismail Qemal Beu. Rugës për në Côte-d’Azur	122
Deklaratat e Ismail Qemalit	123
Roli i Ismail Qemalit në ngjarjen e Vlorës	125
Situata në Shqipëri. Ismail Qemali te Princ Vidi	127
Cilat do të jenë marrëdhëniet e Shqipërisë dhe Greqisë?	
Ismail Qemali na tregon se ato mund dhe duhet të jenë	
të shkëlqyeshme.....	128
Ismail Qemali në Romë	131
Telegrami i Ismail Qemalit për Princ Vidin	133
Dy shefat shqiptarë. Intervista me Esad Pashën dhe Ismail	
Qemal Beun	134
Ismail Qemali në Vjenë.....	143
Në Shqipëri. Ismail Qemal Beu i dërgon një telegram princit	
të Shqipërisë.....	145
Deklaratat e Ismail Qemal Beut.....	146
Ngjarjet e Shqipërisë. Durrësi është gati të mbrohet.	
Thirrja e Qemal Pashës	148
Shqiptarët dhe lufta. Shpresa dhe simpati. Ismail Qemali flet	
për rolin e rëndësishëm që mund të luajë vendi i tij	150
Dasmat	153
Vdekja e Ismail Qemal Beut.....	154
Prej shekujsh Shqipëria luftoi për lirinë e saj	155

Hyrje

Ismail Qemali lindi në Vlorë më 16 janar 1844. U nda nga jeta më 24 janar të 1919, në Peruxha të Italisë.

Gjatë karrierës së tij ka pasur funksione të rëndësishme në Perandorinë Osmane si diplomat, guvernator, këshilltar shteti, kryetar partie politike, por postin më të rëndësishëm të jetës së tij e ka mbajtur në Shqipëri.

Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, si një politikan me eksperiencë, ai u bë kryeministri i parë i shtetit të parë të pavarur shqiptar, që prej rrugës që hapi heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Shkrimet e shumta që janë shkruar për të në shtypin francez të kohës, dëshmojnë se ai ka qenë një udhëheqës largpamës, i cili nuk reshti kurrë së mbrojturi çështjen shqiptare pranë mjediseve angleze, franceze, italiane, austro-hungareze dhe sigurisht ato turke.

Shpesh e ka paguar shtrenjtë këtë angazhim, i ndëshkuar dhe i dëbuar disa herë nga Turqia.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë është nderi dhe kontributi më i madh i tij ndaj kombit shqiptar. Nuk ka qenë një mision i lehtë. Udhëtimet, peripecitë që ka hasur për ta përmbushur, nuk e kanë penguar që t'i shkojë deri në fund këtij misioni.

Por, edhe pas shpalljes së pavarësisë, gjatë viteve 1913-1914 është mundur të mbrojë e të zgjidhë çështjet e brendshme të Shqipërisë, ashtu si edhe territoret e saj të lëna jashtë kufijve zyrtarë.

Aurenc Bebja

**PROPOZIMI QË I BËRI ISMAIL QEMALI SULLTANIT
PËR TË SHPËTUAR PERANDORINË OSMANE**

Le Temps, e mërkurë, 10 mars 1897, ballinë:

Constantinople (*vid* Sofla), 9 mars, 8 h. 25.

Ismaïl Kemal bey, ancien secrétaire de Midhat pacha, qui passe pour avoir exercé souvent une grande influence sur le sultan, vient de lui présenter un long mémoire sur la situation présente. Il le conjure, dans ce document, de prendre lui-même l'initiative des réformes avant la solution de l'affaire crétoise et l'explosion de nouveaux désordres.

Il conclut à la nécessité de refaire une Constitution sur la base de la décentralisation administrative et d'une fédération ottomane laissant aux divers groupes nationaux de l'empire une certaine autonomie. Une Assemblée constituante serait convoquée à Constantinople et, plus tard, un Parlement serait nommé.

Cette initiative d'un homme influent et distingué, qui se tient en dehors de tous les groupes révolutionnaires, trouve chez les musulmans de nombreux adhérents.

(*Service Havas*)

Kostandinopojë (nëpërmjet Sofjes) 9 mars, ora 8:25.

Ismail Bej Qemali, ish-sekretari i Mit'hat Pashës, për të cilin thuhet se shpesh ka pasur një ndikim të madh mbi sulltanin, sapo i ka paraqitur atij një dokument të gjatë në lidhje me situatën aktuale.

Ai e lut, në këtë dokument, që të marrë në dorë iniciativën e reformave përpara zgjidhjes së çështjes së Kretës dhe shpërthimit të çrregullimeve të reja.


E përfundon kërkesën e tij me idenë se ishte e nevojshme të ribëhej një kushtetutë në bazë të decentralizimit administrativ dhe të një federate osmane, duke u lënë grupeve të ndryshme kombëtare të perandorisë një farë autonomie.

Në Kostandinopojë duhet të mblidhej një Asamble Kushtetuese dhe më pas të zgjidhej parlamenti.

Kjo iniciativë e një njeriu të shquar dhe me ndikim, i cili qëndron jashtë të gjitha grupeve revolucionare, gjen shumë mbështetës në mesin e myslimanëve. (Shërbimi Havas)

ARRESTIMI I ISMAIL BEJ QEMALIT

Le Journal, e diel, 25 shkurt 1900, faqe 5:



Frankfurt. - Në “*Gazetën e Frankfurtit*” mbërrin ky lajm nga Kostandinopaja:

Këshilltari i njohur i shtetit, Ismail Bej Qemali, u arrestua dje, gjatë natës.

Ambasada angleze po kërkon lirimin e tij me arsyetimin se, gjatë demonstratave anglofile të muajit dhjetor, me iniciativën e Ismailit, ambasadori britanik mori nga sulltani premtimin që Ismaili nuk do të prekej.

TURQI

L'Événement, e hënë, 16 prill 1900, faqe 3:

TURQUIE

Le sultan voulant éloigner de Constantinople Ismaïl Kemal bey, conseiller d'Etat, bien connu pour ses sentiments anglophiles et de patriote libéral, l'a nommé gouverneur général de Tripoli de Barbarie. Cette nomination est considérée comme un exil.

Le sultan a convoqué au palais la commission ministérielle pour prendre une décision concernant les demandes de la Société française des chemins de fer de Beyrouth-Damas.

Sulltani, i cili dëshironte ta largonte nga Kostandinopoja Ismail Bej Qemalin, këshilltarin e Shtetit, i njohur për ndjenjat e tij anglofile dhe si patriot liberal, e emëroi atë

guvernator të Përgjithshëm të Tripolit, në Barbari¹. Ky emërim konsiderohet si dëbim.

Sulltani thirri në pallat komisionin ministror për të marrë një vendim në lidhje me kërkesat e Shoqërisë Franceze të Hekurudhave Bejrut-Damask.

¹ Termi Barbari/a dhe variacionet e tij: Bregu Berber, Berberi, përdorej nga europianët prej shek. të 16-të deri në atë të 20-të, për t'iu referuar rajoneve veriore të Afrikës së Veriut, të cilat banoheshin nga popujt berberë. Termi përdorej edhe për territore të tjera jobregdetare, të populluara nga berberë. Sot ky territor është pjesë e shteteve moderne të Marokut, Tunizisë dhe Libisë (shën. i autorit.).

ARRATISJA E QEMAL BEUT

Le Constitutionnel, e premte, 4 maj 1900, ballinë:

L'ambassade d'Angleterre a avisé le palais de ce qui s'était passé et l'a prévenu que Ismaïl Kemal désirait se réfugier à l'étranger pour y vivre désormais. Le sultan s'est montré très surpris et a répondu que Ismaïl Kemal pourrait à sa guise, ou bien se rendre à son poste de Tripoli, ou bien s'en aller vivre à l'étranger.

Ismaïl Kemal et ses trois fils ont quitté aujourd'hui la *Salamander* pour s'embarquer à bord d'un steamer de la Compagnie Rubattini, qui va les emmener à Marseille.

Ismaïl Kemal a la réputation d'un homme à l'esprit droit et pondéré : la décision qu'il a prise de quitter son pays indique clairement qu'il regarde comme impossible pour tout individu à l'intelligence éclairée de vivre en Turquie.

Arratisja e Ismail Qemal Beut vazhdon të jetë objekt i të gjitha komenteve.

Ndryshe nga ajo që është thënë më parë, Ismail Qemali, pasi u largua nga “Yildiz Kiosk”, nuk hyri në bordin e “Fuadit”, i cili do ta çonte atë në Tripoli, nga ku do të nisej natën. Ismail Qemali, duke dalë nga “Yildiz Kiosk”, hyri drejt e në luftanijen angleze “Salamander”, me tre djemtë e tij dhe kërkoi strehim, që iu akordua menjëherë.

Ambasada angleze njoftoi Portën e Lartë për atë që kishte ndodhur dhe e paralajmëroi se Ismail Qemali dëshironte të strehohej jashtë vendit, për të jetuar tashmë atje. Sulltani mbeti shumë i habitur dhe u përgjigj se Ismail Qemali, sipas dëshirës së tij, mund të shkonte ose në postin e tij në Tripoli ose të largohej jashtë vendit.

Ismail Qemali dhe tre djemtë e tij u larguan sot nga “Salamander” për t’u nisur me një avulllore të Kompanisë “Rubattini”, e cila do t’i çojë ata në Marsejë.

Ismail Qemali ka reputacionin e një njeriu të drejtë dhe të kthjellët: vendimi që ai ka marrë, për t’u larguar nga vendi, tregon qartësisht se ai e konsideron të pamundur jetesën e çdo individi inteligjent në Turqi.

QEMAL BEU
URIMET E MAHMUD PASHËS - REFORMAT NË TURQI

Le Matin, e hënë, 7 maj 1900, faqe 3:

KEMAL BEU

Félicitations de Mahmoud pacha — Les réformes en Turquie.

ATHÈNES, 6 mai. — Mahmoud pacha a télégraphié de Genève à Kemal bey, le félicitant pour son éloignement de Constantinople.

Kemal bey se prononce ouvertement en faveur de l'introduction de réformes sérieuses en Albanie, jugeant qu'autrement la situation dans cette province pourrait donner lieu à des complications graves.

En résumé, il demande la reconnaissance de l'albanais comme langue officielle, l'utilisation des impôts payés par le peuple albanais en faveur de l'Albanie, et l'établissement d'un système judiciaire impartial.

Par suite des dépêches réitérées qu'il a reçues d'Yildiz-Kiosk, le ministre de Turquie a des entrevues fréquentes avec Kemal bey; il tâche de convaincre ce dernier de retourner en Turquie, mais Kemal oppose un refus catégorique à ces conseils.

Athinë, 6 maj.

Mahmud pasha i telegrafoi nga Gjeneva Qemal Beut, për ta uruar për largimin nga Kostandinopoja.

Qemal Beu është shprehur haptazi në favor të reformave serioze në Shqipëri, duke thënë se ndryshe situata në atë zonë mund të çojë në ndërlikime të rënda.

Pikësëpari, ai bën thirrje për njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, përdorimin e taksave të paguara nga populli shqiptar për Shqipërinë dhe krijimin e një sistemi gjyqësor të paanshëm.

Si pasojë e shkresave të shumta që mori nga “Yildiz Kiosk”, ministri turk ka pasur shkëmbime të shumta me Qemal Beun; ai përpiqet ta bindë këtë të fundit që të kthehet në Turqi, por Qemali i refuzon kategorikisht këto këshilla.

ISMAIL QEMAL BEU

Pro Armenia, 10 maj 1901, faqe 95:

ISMAIL KÉMAL BEY. — Jusqu'ici Abd-ul-Hamid avait affecté d'ignorer la fuite en Europe d'Ismail Kémal bey qui s'embarqua naguère sur le *Salamander* au lieu de rejoindre son poste de gouverneur-général de Tripolitaine, ou il eût été, sans aucun doute, assassiné. Ismaïl Kémal bey est à son tour poursuivi; mais les journaux tures se gardent bien de donner sur lui d'amples détails: ils le désignent en termes volontairement dédaigneux et peu précis:

Deri tani, Abdul Hamidi kishte vendosur ta injoronte arratisjen e Ismail Qemal Beut në Europë, i cili u largua me anijen “Salamander”, në vend që të shkonte në postin e tij të guvernatorit të përgjithshëm në Tripoli, ku pa dyshim do ta kishin vrarë. Ismail Qemal Beu është shpallur të ndiqet penalisht; por gazetat turke janë të kujdesshme që të mos japin detaje të hollësishme; ato shkruajnë qëllimisht me terma mospërfillëse dhe të paqarta:

Kundër Ismail Qemalit, me prejardhje nga Vlora, është lëshuar një urdhër arresti. Ismail Qemali akuzohet për arratisje jashtë vendit dhe për botimet subversive që ka bërë në Athinë, në Egjipt etj., kundër qeverisë perandorake. Mandati i arrestit në fjalë urdhëron autoritetet kompetente të arrestojnë Ismail Qemalin në çdo vend që ai gjendet dhe ta dërgojnë para gjykatës kriminale.

Kështu, një prej burrave të shtetit më të aftë për të shpëtuar vendin, po të ishte dëgjuar, është shtyrë nga vetë “Bisha” që të marrë një qëndrim jo të zakonshëm dhe të largohet prej gjykimeve të një sovrani që e trajton atë si një rebel. Mos vallë Hamidi ka harruar se Ismail Qemali është shumë popullor në Shqipëri?

DËNIM DHE URDHËRARRESTI

Pro Armenia, 25 qershor 1901, faqe 118:

CONDAMNATION ET MANDATS D'ARRÊT. — Une note officielle émanant de la cour d'appel de Stamboul annonce qu'Ismaïl Kémal, natif d'Avlonia (Valona, Albanie) accusé de s'être sauvé à Athènes, dans d'autres pays de l'étranger et en Egypte et d'avoir fait des publications sérieuses contre S. M. I. le Sultan et son gouvernement, été jugé par contumace. Sa culpabilité ayant été établie, il a été condamné à la peine de mort, à la perte de ses droits civiques et à la confiscation de ses biens déjà séquestrés.

Një shkresë zyrtare e gjykatës së apelit të Stambollit njofton se Ismail Qemali, me origjinë nga Vlora (Shqipëri), i akuzuar për arratisjen në Athinë, në shtete të tjera jashtë vendit dhe në Egjipt dhe për publikime serioze kundër lartmadhërisë së tij Sulltanit dhe qeverisë së tij, u gjykua në mungesë. Faji i tij u pohua, kështu ai u dënua me vdekje, me humbjen e të drejtave të tij civile dhe me konfiskimin e pasurisë së tij, të sekuestruar tashmë.

Një shkresë zyrtare nga zyra e prokurorit publik të Stambollit pohon se shqiptarit Faik, i akuzuar për kryerjen e publikimeve të dyshimta, ende në gjendje të lirë, i është dhënë një periudhë e re dhjetëditore për t'u paraqitur në gjykatën penale. Pas kësaj periudhe, ai do të gjykohet në mungesë, pasuritë e tij do të konfiskohen dhe ai do të humbasë të drejtat e tij civile. Autoritetet policore do ta arrestojnë atë, kudo që ta gjejnë.

Një shkresë zyrtare e prokurorit perandorak të gjykatës së apelit të qytetit tonë njoftoi se i emëruari Shahin, ish-zëvendës guvernator i Malit Atos dhe Vlorës, i akuzuar për arratisje jashtë vendit dhe për realizimin e publikimeve të dyshimta, u gjykua në mungesë përpara gjykatës penale të Stambollit. Pasi u vërtetua fajësia e tij, ai u dënua, sipas nenit 68 të Kodit penal osman, me burgim të përjetshëm në një burg të fortifikuar, me humbjen e të drejtave të tij civile dhe me konfiskim të pasurive të tij.

Ismail Qemali nuk është tjetër përveç se Ismail Qemal Beu, ish-këshilltar shtetëror, një nga burrat më të arsimuar dhe më të shquar në Turqinë bashkëkohore.

Sa i përket “të emëruarve Shahin dhe Faik”, “l’Albania é vogel”, suplement politik i revistës “Albania”, komenton

dënimin e tyre në një shkresë të titulluar “Dudumët dhe shqiptarët”¹:

Shqiptarët do ta kenë kuptuar se flitet për Shahin Bej Kolonjën dhe Faik Bej Konicën.

As njëri dhe as tjetri nuk u japin rëndësi këtyre komedive të pahijshme. Ata rezervojnë të drejtën për të demonstruar se nuk mund të shkelen shqiptarët aq lehtë sa në letër.

Megjithatë, do të ishte mirë të theksohet se Faik Bej Konica nuk u “arratis” jashtë vendit, por ai u largua me autorizimin e shtetit (pasi duhet autorizim për gjithçka në Turqi) dhe se ka qenë këtu për pesëmbëdhjetë vjet. Ai nuk ka kërkuar kurrë ndonjë gjë nga qeveria aziatike, nuk njeh një fjalë turqisht dhe nuk e kupton çfarë i kërkohet. Ai është i habitur që bashkëpunimi i tij me një revistë shkencore dhe gjuhësore përshkruhet si armiqësor.

Sa për Shahin Bej Kolonjën, na duket se një vend pune nuk është i përjetshëm; ai donte të jepte dorëheqjen, qeveria nuk ka asgjë për të thënë.

¹ Dudumët - nofkë popullore për turqit në Shqipëri.

**P. S. - DR. LORIS-MELIKOFF SAPO KA MARRË
NGA ISMAIL QEMAL BEU, LETRËN E MËPOSHTME**

Pro Armenia, prill 1902, faqe 80:

P. S. — Le docteur Loris-Mélikoff vient de recevoir d'Ismaïl Kemal bey, la lettre suivante :

Londres, le 16 avril 1902.

Mon cher Docteur,

Au moment où je partais de Bruxelles pour Londres, dimanche passé, j'ai reçu votre aimable invitation pour le 5 courant. J'ai beaucoup regretté d'avoir manqué l'occasion de faire la connaissance des amis d'une cause si juste et si chère à mon cœur.

Je n'ai pas à vous expliquer les raisons

Londër, 16 prill 1902.

Doktori im i shtrenjtë,

Ndërsa po largohesha nga Brukseli për në Londër, të dielën e kaluar, mora ftesën tuaj për datën 5.

Më vjen keq që kam humbur mundësinë për të takuar miqtë e një çështjeje kaq të drejtë dhe të dashur në zemrën time.

Unë nuk do t'ju shpjegoj arsyet pse nuk kam qenë në gjendje të vij ose t'ju përgjigjem, zarfi i kësaj letre do t'i shpjegojë të gjitha.

Do të kthehem së shpejti në Bruksel dhe, pas pak ditësh, shpresoj të shkoj në Paris, ku do të jem i lumtur t'ju takoj dhe t'ju shtrëngoj dorën.

*Përzemërsisht,
Ismaili.*

TURQI - NJË PROGRAM REFORMASH

La République française, e martë, 7 prill 1908, faqe 2:

TURQUIE

Un programme de réformes. — Dans une lettre ouverte adressée à sir Edward Grey et à M. Pichon, Ismail Kemal bey, ancien gouverneur de la province de l'empire ottoman, propose la solution suivante de la question de Macédoine :

L'Europe — dit-il — devrait se rappeler les engagements pris par elle pour les peuples de la péninsule et exiger du sultan l'exécution des siens.

La reprise de l'œuvre des réformes telle que le traité de Berlin la voulut rallierait les suffrages de tous les peuples et de toutes les races. Mais la condition indispensable est que ces réformes s'appliquent à la Turquie d'Europe tout entière.

Në një letër të hapur drejtuar Sir Edward Grey-t dhe z. Pichon (Stephen), Ismail Bej Qemali, ish-guvernator i provincës së Perandorisë Osmane, propozon zgjidhjen e mëposhtme të çështjes maqedonase:

Europa, - thotë ai, - duhet të kujtojë propozimet që u bëri popujve të gadishullit dhe t'i kërkojë sulltanit zbatimin

e tyre. Rifillimi i punës së reformave, sipas traktatit të Berlinit, do të sillte mbështetjen e të gjithë popujve dhe të të gjitha racave. Por, kushti thelbësor është që këto reforma të zbatohen në të gjithë Turqinë Europiane.

Për të vendosur një rend serioz dhe të qëndrueshëm, nevojitet:

1° sigurimi i një sistemi drejtësie për të gjitha krahinat, i cili të garantojë zbatimin e ligjit të vitit 1880 me disa ndryshime;

2° dhënia fund e krizës që shkatërron Maqedoninë dhe shërimi i plagëve të krijuara prej saj.

Fuqitë, për të arritur këtë qëllim, duhet të garantojnë integritetin e Perandorisë Osmane, në mënyrë që të sigurojnë popujt dhe qeverinë turke. Fuqitë mund të zbatojnë atëherë, në mënyrë të sigurt, ligjin organik të vitit 1880, nën kontrollin efektiv të një organi ndërkombëtar, siç është Komisioni European për Rumelinë Lindore.

Ky komision, i shtyrë, por jo i shpërndarë, do të mblidhet në Selanik dhe do të mbikëqyrë, në secilin vilajet, krijimin e një komisioni të veçantë, i cili do të mund të diskutojë lirshëm për modifikimet që mund të sillen në ligjin e vitit 1880.

Gjatë periudhës së ekzistencës së komisionit, qeveria osmane do të gëzonte një lehtësim, që do t'i lejonte asaj riorganizimin e administratës së saj qendrore.

Në të njëjtën kohë duhet të organizohet Shqipëria dhe popullit shqiptar t'i njihet ekzistenca kombëtare.

INTERVISTË E ISMAIL QEMAL BEUT
KUSHTETUTA DO TË ZGJASË

L'Écho de Paris, e mërkurë, 29 korrik 1908, faqe 3:

Interview
d'Ismail-Kemal bey

La Constitution durera
(De notre correspondant particulier)

Genève, 28 juillet.

Le correspondant à Paris du *Journal de Genève* a interviewé Ismail-Kemal bey, qui fut le secrétaire de Midhat pendant le temps de la première révolution en Turquie et dont les tendances libérales lui ont valu une estime qui dure depuis de nombreuses années. Ismail-Kemal bey a fait les déclarations suivantes :

« Désormais la Constitution est un fait et un fait qui durera. Il sera impossible de former un parti contre le régime constitutionnel restauré. On ne se préoccupera plus de savoir si vous appartenez au parti vieux-turc ou au parti jeune-turc, si vous êtes adeptes du Coran ou de l'Évangile. Le passé lugubre où les haines de races ont été jusqu'au carnage entre frères est définitivement clos. Il n'y a pas lieu de douter de la sincérité actuelle du sultan.

(Nga korrespondenti ynë i posaçëm)

Gjenevë, 28 korrik.

Korrespondenti në Paris i gazetës “Journal de Genève”, intervistoi Ismail Qemal Beun, i cili ishte sekretari i Mit’hatit gjatë kohës së revolucionit të parë në Turqi, prirjet liberale të të cilit i kanë dhënë atij prej vitesh një vlerësim të lartë, që ende vazhdon ta ketë.

Ismail Qemal Beu bëri deklaratat e mëposhtme:

- Tashmë, Kushtetuta është një fakt dhe një fakt që do të zgjasë. Do të jetë e pamundur të formohet një parti kundër regjimit kushtetues të rivendosur. Ne nuk do të shqetësohemi më nëse ju i përkisni Partisë së Vjetër Turke ose Partisë së Re të Xhonturqve, nëse jeni ndjekës të Kuranit ose të Ungjillit. E kaluara e tmerrshme, ku urrejtjet ndaj racave çuan në masakrat mes vëllezërve, u mbyll përfundimisht. Nuk ka asnjë arsye për të dyshuar në sinqeritetin e tanishëm të sulltanit.

Tridhjetë e dy vjet më parë, ai shkatërroi Kushtetutën, pasi e kishte vetëshpallur, por kohët kanë ndryshuar dhe sovrani tani e di se nëse do të kërkonte të merrte përsëri atë që sapo dha, ai do të rrezikonte fronin e tij. Ai e ka kuptuar rrezikun dhe nuk mund të harrojë në të ardhmen se, nëse dëshiron të marrë përsëri atë që populli mori prej tij, rreziku do të bëhej sërish kërcënues.

Populli turk nuk është më i njëjtë me atë të 30 viteve më parë: ai ka mësuar shumë dhe nuk do të udhëhiqet më si në të kaluarën.

Detyra e të gjithë patriotëve turq është të ndihmojnë në punën rigjeneruese. Meqenëse sulltani po fillon në rrugën